

Njoftim për pjesëmarrjen e personelit në kursin e gjuhës italiane të ofruar nga Ambasada Italiane në Tiranë

Zyra e atasheut ushtarak italian, në Tiranë, informon se në gjashtëmuajorin e dytë të këtij viti do të zhvillojë një kurs të gjuhës italiane falas për personelin ushtarak e civil të MM / SHPFA. Kursi do të zhvillohet pas orarit zyrtar të punës, dy herë në javë nga një orë e gjysmë, me një total prej 30 orësh. Materialet didaktike do të sigurohen nga pala italiane. Vendi i zhvillimit të kursit do të përcaktohet pas përzgjedhjes së kandidatëve që do të ndjekin kursin (5 – 10 kandidatë). Kursi zhvillohet kryesisht për kandidatët që janë prioritet për ndjekjen e kurseve që do të zhvillohen në Itali, gjatë vitit të ardhshëm akademik.

Afati i aplikimit: 28 mars 2018.